

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 208/24 dhe 16/25), duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga NOVA LJUBLJANSKA BANKA d.d., me seli në Trg Republike 2, 1000 Lubjanë, Slloveni, përmes Shoqërisë së Avokatëve Knezoviq dhe bashkëpunëtorët nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 16.06.2026, miratoi këtë

AKTVENDIM

1. Vërtetohet se përqendrimi, me të cilin NOVA LJUBLJANSKA BANKA d.d., me seli në Trg Republike 2, 1000 Lubjanë, Slloveni, do të fitojë kontroll të pavarur mbi ADDIKO BANK AG, me seli në Canetti Tower, Canettistraße 5/06 12, 1100 Vjenë, Austri, nëpërmjet ofertës publike vullnetare për marrjen e kontrollit, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe **është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.**

2. Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë takse administrative për njoftimin për përqendrim në shumë prej 6.000,00 denarë, si dhe për aktvendimin në shumë prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për Taksat Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11, 84/12, 192/15, 23/16 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 151/21), në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, shifra dhe programi i të hyrave 72231300.

3. Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e këtij aktvendimi.

Arsyetim

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më 21.05.2026 në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) u dorëzua njoftim për përqendrim nga NOVA LJUBLJANSKA BANKA d.d., me seli në Trg Republike 2, 1000 Lubjanë, Slloveni, me të cilin NOVA LJUBLJANSKA BANKA d.d. do të fitojë kontroll të pavarur mbi ADDIKO BANK AG, me seli në Canetti Tower, Canettistraße 5/06 12, 1100 Vjenë, Austri.

Komisioni filloi shqyrtimin e njoftimit që nga dita e pranimin të tij dhe, në bazë të të dhënave të dorëzuara në njoftimin për përqendrim dhe bashkëngjitjeve të tij, konstatoi si vijon:

Veprimtaritë kryesore afariste të ndërmarrjeve të përfshira:

NOVA LJUBLJANSKA BANKA d.d. ndjek një model universal bankar që përfshin bankat me pakicë, korporata dhe investime, si dhe menaxhimin e aseteve, sigurimin bankar dhe lizingun.. NOVA LJUBLJANSKA BANKA d.d. është banka udhëheqëse në Slloveni dhe gjithashtu grupi më i madh financiar, i matur sipas mjeteve, me seli në rajonin e saj amë të Evropës Juglindore, në vendet e ish-Jugosllavisë.

NOVA LJUBLJANSKA BANKA operon në një numër të madh tregjesh strategjike të huaja dhe aktualisht ka operacione bankare në pesë vende të tjera, përkatësisht në Bosnjë dhe Hercegovinë (ku operon përmes dy bankave, një në Federatë dhe një në Republikën Srpska), Mal të Zi, Kosovë, Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe Serbi. Në secilin prej këtyre vendeve, Grupi NLB ka pozitë të fuqishme në treg me pjesëmarrje tregu (e matur sipas mjeteve) që tejkalon afërsisht 10%. Përveç kësaj, NLB operon me shoqëri për investime/menaxhim të mjeteve dhe lizing në këto tregje, si dhe në Kroaci përmes Mobil Leasing, Zagreb.

Grupi NLB në Republikën e Maqedonisë së Veriut aktualisht ka 3 shoqëri të lidhura:

- NLB Banka SHA Shkup, me seli në rr. „Vodnjanska“ nr. 1, Shkup, me NUAS 4664531, me veprimtari prioritare – ndërmjetësim tjetër monetar;
- Shoqëria për lizing NLB LEASE&GO SHPK Shkup, me seli në rr. „Vodnjanska“ nr. 1, Shkup, me NUAS 7628838, me veprimtari prioritare – lizing financiar; dhe
- Shoqëria për administrimin e fondeve të hapura dhe të mbyllura investuese NLB FONDOVI SHA Shkup, me seli në bul. „Partizanski Odredi“ nr. 14A-1/2, Shkup, me NUAS 6364578, me veprimtari prioritare: veprimtari të administrimit të fondeve.

Grupi Addiko është grup bankar i specializuar, i cili fokusohet në ofrimin e produkteve dhe shërbimeve bankare për konsumatorët dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) në Evropën Qendrore dhe Juglindore (EQJL). Grupi përbëhet nga ADDIKO BANK AG, bankë amë austriake plotësisht e licencuar, e regjistruar në Vjenë, Austri, e listuar në Bursën e Vjenës dhe e mbikëqyrur nga tregu financiar austriak dhe Banka Qendrore Evropiane, si dhe nga gjashtë banka bija, të regjistruara dhe të licencuara, të cilat operojnë në pesë vende të EQJL-së: Kroaci, Slloveni, Bosnjë dhe Hercegovinë (ku operon përmes dy bankave), Serbi dhe Mal të Zi.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i paraqitur bie nën dispozitat e Ligjit, pasi i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafët (2), (3) dhe (4) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat, gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës*, vlerësoi se përqendrimi i paraqitur, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të njëjtin, pasi nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për ngritjen e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS

KRYETARE

Mr. Малинка Силјановска Николиќ